

KËSHILLI KONSULTATIV
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 34/prot

Tiranë, më 26 01 2023.

VENDIM

Nr. datë 26/1/2023

PËR

**MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE
VENDORE TË DATËS 26.1.2023**

Këshilli Konsultativ, bazuar në Ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", si dhe Vendimin Nr. 910 datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për çështjet, objektet konsultimi, dhe strukturën, procedurën, formën, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme, objekt konsultimi në mbledhjen e datës 26.1.2023 vendosi:

1. Për projektligjin "Për burimet ujore" propozuar nga Kryeministria anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, të miratojë rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
 - Neni 2, pika 4, emërtimi "Autoriteti përkatës i qeverisjes vendore", të zëvendësohet me termin "Bashkia";
 - Kreu II, Neni 6, "Organet kombëtare të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore", duhet specifikuar administrimi i ujit në nivel vendor;
 - Neni 8, "Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit", të përfshihet në proces NJVV, ose të mbështesë organet me Vendim të Këshillit Bashkiak;
 - Neni 9, "Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore" pika "ë" koordinon me pushtetin vendor/ Qarqet apo Bashkitë;
 - Neni 10, "Këshilli i Basenit Lumor" të shtohet pika "e" si vijon: "koordinon dhe informon bashkinë nën juridiksionin territorial të secilës ndodhet baseni";
 - Neni 14, "Autoritetet kompetente" pika 3, të shtohet paragrafi "Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore duhet të informojë bashkitë me shkresë zyrtare për elementet e informacionit";

- Neni 16, “Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, neni 6, të shtohet paragrafi “NJVV duhet të përshtatin strategjitë e tyre lokale bazuar mbi këtë strategji dhe legjislacionin e ri jo më vonë se dy vjet pas miratimit”;
- Neni 20, pika 1, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) ndjek zbatimin e programeve të masave të përcaktuara në planet e menaxhimit të baseneve lumore për ujërat sipërfaqësorë duke siguruar, të shtohet paragrafi “në bashkëpunim me NJVV”;
- Neni 21, të shtohet paragrafi “AMBU bashkëpunon me NJVV për përputhshmërinë e këtyre objektivave, që të mos jenë vertikale pafund, por bazuar në realitetin bazik;
- Të përfshihet pushteti vendor në këtë proces, në aktet nënligore dhe strukturat kombëtare si dhe duhet një formatim i Këshillit Kombëtar të Basenit Ujor më përfshirje të pushtetit lokal;
- Të përfshihet Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës të këshillave të Qarqeve në Këshillat e Baseneve Ujore si një organ koordinues në raste emergjente.

2. Për projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrimin Evropian 2022-2030” propozuar nga Kryeministria, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, të miratojë rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë;

- Të standardizohen dhe të përcaktohen detyra konkrete për pushtetin vendor në Planin e Veprimit të Strategjisë në mënyrë që Ministria e Brendshme të qartësohet për monitorim dhe vlerësim;
- Te kapitulli “Demokracia dhe fuqizimi institucioneve dhe qeverisjes së mirë”, seksioni “Decentralizimi dhe fuqizimi i qeverisjes vendore”, të shtohet një paragraf lidhur me ecurinë e detyrimeve të prapambetura të pushtetit lokal, problematikat që lidhen me shlyerjen e këtyre detyrimeve, rritjen e efikasitetit nga ana e bashkive për të bërë parashikime financiare më të sakta bazuar në fluksin e të ardhurave dhe shpenzimeve që parashikohen të bëhen;
- Të përmirësohen proceset për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Tregues i mundshëm performance mund të jetë dhe ulja e stokut të detyrimeve të prapambetura në vite duke vendosur një vlerë të synuar të stokut të detyrimeve të prapambetura ndaj PBB për vitin 2030, ose një tregues mund të jetë stoku i detyrimeve të prapambetura/totalit të shpenzimeve vjetore të miratuara;
- Strategjia të marrë në konsideratë dhe masat për uljen e detyrimeve të prapambetura, rritjen e aftësive të menaxhimit financiar të bashkive, rritjen e aftësisë planifikuese si dhe disiplinimi i kryerjes së investimeve në përputhje me buxhetet në dispozicion dhe kapacitetet fiskale.

Të parashikohet si pjesë e arritjeve ku mund të cilësohen edhe:

- Miratimi i planeve të integritetit në nivel bashkie si dokumente politike kundër korrupsionit dhe forcimit të integritetit në nivel vendor;
- Miratimi i planeve vendore të barazisë gjinore si dokument me rëndësi për forcimin e parimit të barazisë gjinore në qeverisjen vendore dhe fuqizimin ekonomik të grave në nivel vendor si dhe implementimi i fondit social sepse një pjesë e madhe e

bashkive nuk përfitojnë nga fondi social për shkak të vështirësive lidhur me zbatimin e tij ligjor dhe praktik.

Të shtohet si tregues, meqenëse qeverisja vendore është pjesë e shtyllës e lidhur me qeverisjen e mirë:

- Indeksi i integritetit në qeverisjen vendore;
 - % e bashkive që përfitojnë nga fondi social.
3. Për projektvendimin **“Për miratimin e platformës së monitorimit dhe verifikimit”** propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë , anëtarët e Këshillit Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim.
4. Për projektvendimin **“Për miratimin e kritereve dhe procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë në furnizimin me gaz natyror dhe mënyrën e trajtimit të tyre”** propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, anëtarët e Këshillit Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre , të miratojë rekomandimet përkatëse për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Pika 2.1.3 II kriteret për kualifikim si klient në nevojë, të rishikohet termi “zotëron”;
 - Pika 2.1.4, “ c” të formulohet si vijon:
 - Të ardhurat mujore faktike të përgjithshme (neto) nuk kalojnë 90% (nëntëdhjetë përqind) të nivelit të pagës minimale për secilin pjesëtar të familjes, ku një familje e veçantë përbëhet të nivelit nga 6 (gjashtë) ose më shumë pjesëtarë.
 - Të riformulohet pika 2.1.5;
 - Pika 2.2, të zëvendësohet fjala “kërkesa” me “kritere”;
 - Pika 3.3, II “Procedura për kualifikimin e klientëve në nevojë”, ku “Njësia administrative vendore” duhet të zëvendësohet me “Zyra vendore e sigurimeve shoqërore” e cila pret dhe aplikimin;
 - Pika 3.6, zëvendësimi i fjalës “aplikon” me fjalën “dorëzon” meqenëse aplikimi është kryer njëherë;
 - Pika 5.4.3, VI “Furnizimi me gaz natyror për klientin në nevojë” të përcaktohet kufiri maksimal, i gazit për person ashtu siç përmendet minimali;
 - Pika 5.6.2, të përmendet rastet kur përdoret lidhëza dhe/ose apo duhet të jetë vetëm “dhe”;
 - Pika 6.2. VI “Masa të tjera mbrojtëse zbatuar për klientin në nevojë”, të shpjegohet sa duhet të jetë niveli minimal i detyrimit;
 - Pika 6.2.2, temperatura -15 gradë mesatare ditore është një vlerë shumë më e ulët se mesatarja reale dhe në zonat më të ftohta;
 - Të saktësohen dhe unifikohen termat e përdorur ne Kap III dhe VII si vijon:
 - Njësia administrative vendore;
 - Institucione përkatëse vendore;
 - Njësia vendore administrative.

- Pika 2.1.4, të shmanget burokracitë për përgatitjen e dokumentacionit, procedurën dhe lëshimin e vërtetimit për klientët në nevojë për marrjen e shërbimit.
5. Për projektvendimin **“Për përcaktimin e rasteve dhe rregullave për shpërbimin në natyrë të shpronësimeve për interes publik”** propozuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, anëtarët e Këshillit Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre shprehën dakordësinë në parim.
 6. Për projektvendimin **“Për një ndryshim në vendimin nr.414, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”**” propozuar nga Ministria e Mbrojtjes , anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, të miratojë rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
 - Pika 3.2 e VKM mbetet e pandryshuar, ndërkohë që projektvendimi shton përveç marrjes me qera, edhe blerjen e automjeteve dhe pajisjeve të tjera duke limituar në këtë mënyrë përdorimin e fondit të kushtëzuar për prioritetet e tjera të parashikuara në pikën 3.1. Gjithashtu, mungesa e parashikimit të specifikimeve teknike lidhur me blerjen e automjeteve apo makinave të tjera, mund të krijojë kushte për përdorimin abuziv të këtij fondi në bashki të ndryshme. Në këtë mënyrë, ndryshimi duhet të shihet i lidhur edhe me pikën 3.2 të VKM nr.414/2021;
 - Të evidentohet qartësisht në relacion se cila është arsyeja që ka sjellë nevojën për ndryshim dhe nuk evidentohen se cilat kanë qenë problematikat me të cilat janë hasur bashkitë lidhur me zbatimin e VKM nr.414/2021;
 - Të parashikohet me akt ligjor specifikimet teknike për blerjen e makinave, gjë që jo vetëm nuk është shpjeguar në relacion, por nga ana tjetër duhet të bëhet me akt ligjor dhe jo përmes relacionit.
 7. Për praktikën **“Për ngritjen e task-forcës ndërinstitucionale për sezonin turistik veror 2023”** propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, anëtarët e Këshillit mbështetur në mendimet e tyre, shprehën dakordësinë në parim.
 8. Për Raportin e monitorimit për vitin 2021 të **“Dokumentit të Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020-2035”** propozuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, mbështetur në mendimet e tyre anëtarët e Këshillit Konsultativ, shprehën dakordësinë në parim.
-
9. Për projektligjin **“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”**” propozuar nga Ministria e Brendshme, anëtarët e Këshillit u shprehën parimisht dakord dhe mbështetur në mendimet e tyre, të miratojë rekomandimet përkatëse për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
 - Neni 1, të përcaktohet dhe fusha e përgjegjësisë, duke u riformuluar si vijon:

- Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së është institucion varësie, person juridik, publik, në varësi të ministrit përgjegjës për hartimin e politikave, koordinimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.
- Neni 2, të përcaktohet gama e shpenzimeve të nevojshme për kryerjen e vullnetarizmit me qëllim që të mos ngelet vetëm në diskrecion të bashkive, (p.sh.. shpenzime transporti, ushqimi, trajnimi). Të riformulohet “shpenzime të nevojshme për kryerjen e vullnetarizmit sipas parashikimeve të ligjit nr 45/2016 “Për vullnetarizmin”;
- Nenin 3 pika 5, për nivelet madhore sistemi i konkurrimit të qëndroje brenda sistemit për të promovuar rritjen në karrierë të punonjësve të niveleve të mesme/larta duke u bazuar në parimin e promovimit të personelit të MZSH dhe duke ndjekur të njëjtën logjikë si për dy nivelet e tjera (mbi bazë të kriterit të vjetërsisë). Jo çdo punonjës i administratës publike (nivel i lartë drejtues) mund të ketë të njëjtën eksperiencë si edhe punonjësit që kanë punuar në nivelin e lartë të MZSH.
- Neni 5, të përcaktohet shprehimisht përbërja e anëtarëve të komisionit të posaçëm referuar dispozitës se “Komisioni ngrihet me urdhër të kryetarit të bashkisë dhe ka në përbërje anëtarë nga shërbimi vendor i MZSH-së, të nivelit të mesëm dhe punonjës të strukturës përgjegjëse për urbanistikën” mund të përcaktohet numri i anëtarëve të komisionit.

Znj. Romina KUKO
Zv/Ministër i Brendshëm
Bashkëkryetar



Z. Aldrin DALIPI
Kryetar i Shoqatës së Këshillit
të Qarqeve të Shqipërisë
Bashkëkryetar

